

Arbitrazh, edhe në Shqipëri

“Ai që e ka provue din edhe me të mësue”, thotë populli.

Prandaj, kur departamenti i ligjit në universitetin “Epoka” shpalli thirrjen për një shkollë verore mbi arbitrazhin ndërkombëtar, aplikuam pa hezitim për të marrë një eksperiencë të dorës së parë nga arbitra ndërkombëtarë, profesionistë dhe studiues të dedikuar të fushës.

Nisma e Dr. Dini Sejko, Dr. Gentjan Skara dhe Dr. Alba Gërdeci, e mbështetur nga projekti “Research Expertise from the Academic Diaspora” i Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) - nuk ishte vetëm një mundësi për t’u njohur me konceptet bazë të arbitrazhit ndërkombëtar, por edhe shtysa kryesore që ne, si studiuese të reja të së drejtës, të përmblidhnim dijet e fituara dhe bërë kërkim shtesë, në këtë artikull.

Pjesëmarrja në shkolla të tilla verore, me profesionistë të këtij kalibri, ta zgjon kuriozitetin si asgjë tjetër, edhe kur temperaturat janë shumë të larta për t’u përballuar.

Një përmbledhje të informacionit shterues të marrë në 1-javë, e gjeni në këtë artikull.

Arbitrazhi Ndërkombëtar: Një Zgjidhje Praktike për Konfliktet Ndërkombëtare

Në botën e sotme të biznesit global, konfliktet janë të pashmangshme. Por a ka një mënyrë më të shpejtë dhe më pak të kushtueshme për t’i zgjidhur ato? **Arbitrazhi ndërkombëtar ofron një alternativë moderne dhe efikase ndaj gjykatave tradicionale, duke ofruar përfitime të shumta për palët e përfshira.**

Arbitrazhi ndërkombëtar është një proces privat dhe i bazuar në marrëveshje, ku dy ose më shumë palë pajtohen të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre përmes arbitrave të pavarur, të zgjedhur nga vetë ato. Ky proces, **ndryshe nga gjykatat tradicionale**, ofron **fleksibilitet dhe shpejtësi**, duke i lejuar palët të arrijnë një zgjidhje në një kohë shumë më të shkurtër.

Një nga avantazhet kryesore të arbitrazhit ndërkombëtar është **natyra e tij neutrale dhe private**. **Vendimet** e marra janë **të detyrueshme dhe duhet të respektohen** nga të gjitha palët, duke siguruar një zgjidhje të qëndrueshme të konflikteve.

Ligji material që përdoret në arbitrazhin ndërkombëtar është **kyç** për zgjidhjen e drejtë të konflikteve. Palët në arbitrazh kanë **lirinë të zgjedhin ligjin** që do të qeverisë mosmarrëveshjen e tyre. Ky ligj mund të jetë ai i një vendi të caktuar, ose një kombinim rregullash dhe parimesh të pranuar ndërkombëtarisht. **Ligji material përfshin të drejtat dhe detyrimet** themelore të palëve, ndërsa **ligji procedural përcakton mënyrën se si do të zhvillohet procesi i arbitrazhit.**

Në arbitrazh, palët luajnë një rol aktiv në përzgjedhjen e arbitrave dhe në hartimin e procedurës që do të ndiqet. Ky fleksibilitet i lejon ata të krijojnë një proces që është më i përshtatshëm për nevojat dhe interesat e tyre specifike. Arbitrazhi ndërkombëtar shpesh kombinon elemente të sistemeve ligjore civile dhe të Common Law, duke ofruar një hibrid të procedurave që mund të përshtaten për çdo situatë të veçantë.

Në botën globale të sotme, ka pasur zhvillime të rëndësishme në ligjet që rregullojnë arbitrazhin ndërkombëtar. Për shembull, në vitin 2020, **Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID) përditësoi rregullat** e saj për të përfshirë më shumë **fleksibilitet dhe transparencë në procesin e arbitrazhit.**

Në Shqipëri, arbitrazhi ndërkombëtar është rregulluar nga Ligji Nr. 10385, datë 24.2.2011, për Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996, Kodi i Procedurës Civile. Këto ligje përmbajnë dispozita që lehtësojnë procesin e arbitrazhit dhe zbatimin e vendimeve të tij, duke ofruar një kornizë të qartë dhe të qëndrueshme për palët e përfshira në arbitrazh.

Një formë e re dhe interesante e arbitrazhit është **arbitrazhi i investimeve.** Ky proces lejon investitorët e huaj të hapin procedura arbitrazhi kundër shteteve në rast të shpronësimit të padrejtë ose mosrespektimit të marrëveshjeve të investimeve. Arbitrazhi i investimeve është bërë **një nga mënyrat më të shpejta dhe efikase për të mbrojtur investimet private në nivel global.**

Palët që përfshihen në arbitrazhin ndërkombëtar zakonisht janë kompani ose investitorë ndërkombëtarë dhe shtete ose entitete shtetërore. Përzgjedhja e arbitrave është një proces i rëndësishëm, pasi arbitrët duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm. Palët zakonisht zgjedhin një arbitër secila, dhe një arbitër i tretë zgjidhet nga dy arbitrat e parë ose nga një institucion arbitrazhi.

Në përfundim, arbitrazhi ndërkombëtar është një zgjidhje moderne dhe efikase për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare. Ai ofron shpejtësi, fleksibilitet dhe një sistem të besueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Nëse jeni një biznes ndërkombëtar ose një investitor, pse të mos konsideroni arbitrazhin si një alternativë ndaj gjykatave

tradicionale? Arbitrazhi ndërkombëtar mund të jetë çelësi për zgjidhjen e konflikteve komplekse të kohës sonë

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve: Pse arbitrazhi dhe jo gjykatat tradicionale?

Që në kohë të hershme, me nisjen e përdorimit të arbitrazhit si një mekanizëm funksional për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, mund të themi se arbitrazhi ishte dakordësuar si një metodë efektive për shmangien e rrugës tradicionale të gjykatave. Në kuadër të efektshmërisë dhe produktivitetit, krijimi i një tribunali me arbitra të zgjedhur në mënyrë të pavarur nga të dyja palët, duket si një zgjedhje e mirë për të siguruar paanshmëri. Megjithatë, a është arbitrazhi një mjet që prevalon nga ana teknike dhe funksionale për sa i përket gjykatave? Në vijim do të analizojmë disa aspekte që mund të merren në konsideratë në këtë drejtim.

Gjykatat e ligjit janë pjesë e pushtetit gjyqësor, ndaj si të tilla janë të krijuara dhe të rregulluara në ligjin e një vendi dhe funksionojnë bazuar mbi parime të gjithëpranuara kushtetuese. Gjykatat sigurojnë një institucion ku mbi baza, prova e fakte, palët mund të ngrenë pretendime në lidhje me të drejtat e tyre të shkelura. Kjo inicion një proces të gjatë pretendimesh, debati gjyqësor, shqyrtimi provash, të gjitha elementë me rëndësi të vecantë në procesin gjyqësor. Ligji siguron disa shkallë në lidhje me pretendimet e palëve me qëllim e vetëm shqyrtimin e cdo mundësie për ndryshim të elementëve të situatës dhe për të konsumuar cdo mjet të mundshëm për vënien në vend të së drejtës. Në këtë drejtim, palët janë të detyruara të ndjekin cdo hallkë të procesit deri në vendimarrje dhe më tej duhet të zbatojnë afatet e detyrueshme për konsumimin e shkallëve të tjera.

Krahasimisht, **arbitrazhi siguron një rrugë më të thjeshtë dhe jotradicionale që zbatohet me vullnetin e të dyja palëve, të cilat në interesin e tyre e kanë gjykuar këtë mjet si më funksional, dhe kanë rënë dakord mbi kushtet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve potenciale.** Duke gjykuar që kryesisht këtë metodë e përdorin kompanitë apo subjektet që kontraktajnë mes tyre ose me shtete, kjo metodë ka kosto shumë herë më të larta, por në vija paralele me kohën e shkurtër për të cilën është dizajnuar për të funksionuar.

Në arbitrazh ka një nivel teknik më të lartë se në gjykata. Palët përzgjedhin ekspertë të fushës objekt mosmarrëveshjeje dhe problematika diskutohet në detaje, nga orë në ditë të tëra, pa kufizime për sa i përket zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Nëse në gjykata do flisnim për konceptin e ekonomisë gjyqësore, në procesin e arbitrazhit palët kanë në dispozicion kohën dhe mjete të shumta të përzgjedhura prej tyre për të diskutuar çdo pjesë të konfliktit, si dhe për t'i rinegociuar kushte të reja, shpesh duke krijuar hapësira

të reja biznesi mes palëve dhe duke sjellë kontrata të reja mes tyre. Në këtë drejtim, palët kanë interes të zgjedhin arbitrazhin pasi mund të mos i besojnë gjykatave të njërit vend apo tjetrit pasi duan të sigurohen që biznesi i tyre të mos çenohet nga legjislacioni ekzistent i një vendi, i cili mund të parashikojë zgjidhje jo në favor të marrëdhënieve aktuale të biznesit që ekzistojnë mes palëve. Për të siguruar transparencë totale, i besohet tribunaleve botërore dhe i nënshtrohet zgjidhja e mosmarrëveshjes rregullave dhe rregullimeve ndërkombëtare si për shembull: rregullat e [Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë ICC](#) ose [udhëzimet e Shoqatës Ndërkombëtare të Avokatëve](#) (për përzgjedhjen e arbitrave).

Duke qenë se subjekte të arbitrazhit janë biznese dhe kompani të mëdha, konfidencialiteti është një tjetër komponent me vlerë për to që vlen në këtë rast dhe për tribunalin i cili do zgjidhë dhe gjejë një rrugë të kënaqshme për të dyja palët. Nëse procesi do ndiqej në gjykata tradicionale do ishte një proces publik dhe shpesh kjo mund të çenojë pozitën në treg, marrëdhënien me konsumatorin por edhe më gjerë.

Përzgjedhja e arbitrave bëhet në mënyrë konvencionale nga palët, pra ata mund të përzgjedhin duke u siguruar vetë mbi kredibilitetin dhe aftësitë profesionale. Në raport me gjyqtarët që shpesh janë të panjohur për palët, kjo pjesë i jep më shumë besueshmëri procesit. Gjithsesi palët mund të konsiderojnë faktin që gjyqtarët kanë kaluar disa hallka deri në përzgjedhjen për të gjykuar çështjen.

Edhe nëse kishte një hendek midis dy alternativave për shkak të faktit që gjykimi tradicional vjen nga baza të forta institucionale dhe ligjore si edhe nga precedenti gjyqësor, tanimë ka struktura institucionale shumë të mira dhe efektive ndërkombëtare që janë konsoliduar me kalimin e viteve. Gjithashtu praktika në arbitrazh është e gjerë dhe ofron precedent sipas tribunaleve të ndryshme botërore.

Në konkluzion, besueshmëria dhe niveli i lartë teknik e favorizojnë arbitrazhin në raport me gjykimin nga gjykatat. Reduktimi i kohës së konsumuar në shkallë të ndryshme gjykimi, megjithëse përbën mjet të mirë për rivendosjen e së drejtës, është element që favorizon palët pasi problematika e lindur midis tyre mund të ketë kosto financiare nëse kalon një kohë e caktuar. Fakti që palët mund të zgjedhin mosmarrëveshjen përmes një ekipi me arbitra dhe ekspertësh duke gjetur mënyrat më të mira për të ngritur pretendime fituese dhe vendimtare për sa i përket marrëveshjeve të biznesit, përbën një avantazh të dukshëm. Subjektet e zgjedhin më së shumti këtë mjet pasi superojnë çdo problematikë në lidhje me juridiksionin, kompetencat dhe vetërregullojnë duke dakordësuar çdo komponent në zgjidhjen e një konflikti potencial. Arbitrazhi mund të rezultojë në disa seanca mjaft intensive, por palët sigurohen që çështja të zgjidhet në

mënyrën më të mirë të mundshme dhe duke mbrojtur interesat e tyre ekonomike si edhe shpeshherë duke rezultuar në lidhjen e marrëveshjeve të reja për sa i përket të bërit biznes mes tyre.

Arbitrazhi në Shqipëri

Një odise arbitrazhi

10 vite iu deshën Odisesë për t'u rikthyer në Itakën e tij. Një dekadë iu desh edhe Shqipërisë për të plotësuar vakumin ligjor në fushën e arbitrazhit. Megjithëse, ia vlen të shtohet se, angazhimi i shtetit shqiptar për të ofruar procese më fleksibël për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, është më i hershëm se kaq.

Prej vitit 2000 shteti ka aderuar në disa konventa ndërkombëtare, përmendim këtu: [Konventën Evropiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar](#) dhe [Konventën e New York-ut “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”](#) - tekstet e të cilave janë përmbajtje e praktikave dhe standardeve më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

Arbitrazhi, si formë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ka pasur një rregullim të hershëm (të miratuar me ligj në vitin 1996) në Kodin e Procedurës Civile. Këto përcaktime u shfuqizuan në vitin 2013, për të kaluar në një odise të gjatë përpjekjesh dhe angazhimesh për përmirësimin e kornizës së brendshme ligjore.

Një ligj arbitrazhi në Shqipëri

Sikurse forma nuk ka funksion pa përmbajtjen, ashtu edhe aderimi në konventa ndërkombëtare zbehet nëse angazhimi nuk është konkret dhe i shprehur në legjislacionin e brendshëm. Fatmirësisht, vendi ynë e ka tashmë një ligj për arbitrazhin, efektet e të cilit do të jenë padyshim krijimi i një klime më të sigurt biznesi për ato marrëdhënie ndërkombëtare tregtare ku sipërmarrjet shqiptare apo shteti janë palë.

[Ligji Nr. 52/2023 “Për Arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”](#) rregullon dhe promovon procesin e arbitrazhit, si një nga metodat alternative më efektive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve. Shprehimisht, ligji ka për qëllim organizimin e zhvillimit të procedurave të arbitrazhit në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive (shiko Nenin 2 të ligjit).

Ligji rregullon arbitrazhin kombëtar dhe ndërkombëtar, kushtet për ushtrimin e profesionit të arbitrit, marrëveshjen mes palëve, rregullat dhe procedurat e zhvillimit të

arbitrazhit, ekzekutimin e të vendimeve të arbitrazhit, dhe aspekte të tjera formale e procedurale, që gjenden në ligjin me 49 nene.

Arbitrazh kombëtar vs ndërkombëtar

Arbitrazhi është një shprehje e vullnetit të palëve, që kanë një marrëdhënie juridike mes tyre, për të zgjidhur mosmarrëveshjen e krijuar, nga një arbitër ose trup arbitrash, sipas autonomisë së tyre.

Arbitrazhi ka karakter ndërkombëtar kur:

- palët kanë vendbanim, vendqëndrim ose seli në shtete të ndryshme
- nuk është Shqipëria vendi i arbitrazhit ose vendi me të cilin lidhet mosmarrëveshja
- një pjesë e detyrimeve që vijnë nga marrëdhëniet mes palëve, përmbushet jashtë Shqipërisë

Me fjalë të tjera: ligji krijon hapësirë që të aplikohen parashikimet e tij, sa herë që arbitrazhi vendas dhe ndërkombëtar të zhvillohen në Shqipëri.

Shumë e rëndësishme është forma e marrëveshjes së arbitrazhit. Nëse nuk bëhet me shkrim, do të jetë e pavlefshme. E shkruar, mund të jetë qoftë një klauzolë e kontratës kryesore ose një kontratë e dedikuar, krahas kontratës që rregullon marrëdhënien juridike mes palëve. Po kujt do t'i interesonte të cënonte marrëdhënien, për një mungesë shkrese, apo jo?

Bashkëautore:

Gentiana Kapllani - LL.M. në të Drejtë Ndërkombëtare dhe Tregtare

Edmorela Myftaraj - BSc në drejtësi

Klea Kallulli - BSc në drejtësi